



---

# RAPORT I VEÇANTE

Për situatën e krijuar nga mosëkzekutimi i vendimeve  
gjyqësore të formës së prerë.

## Hyrje

Raporti i Veçantë që po ju prezantojmë është një sinteze e përpjekjeve të vazhdueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së individëve, të garantuar nga sistemi ligjor për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesa më kryesore dhe më e rëndësishme e realizimit të së drejtës në një shtet ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të funksionojë nëse vetë ndërtuesit e tij nuk realizojnë problemin më themelor, atë të përfitimit materialisht të kësaj të drejte dhe të garantimit jo vetëm ligjor, por edhe të mbrojtjes efektive të saj.

Ky raportim bëhet në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore, si dhe detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për të prezantuar gjatë vitit tematika të rëndësishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve të Veçanta.

Informimi për gjendjen e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është pasqyruar në raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit ndër vite si dhe në informacione të veçanta drejtuar autoriteteve përgjegjëse. Megjithatë situata nuk rezulton të ketë ndryshuar. Numri i ankesave të qytetarëve drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërhyrë pranë autoriteteve përgjegjëse për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht, vazhdon të rritet. Bashkë me numrin e ankesave për këtë objekt, rritet dhe fatura financiare e shtetit për detyrimet që ky i fundit (në rastet kur është debitor) i ka individëve gjyqfitues.

### **1. Kuadri ligjor që garanton zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.**

E drejta për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore e individit, është e garantuar në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se : *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, në nenin 6 të saj sanksionon se : *“Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të*

*arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila të vendosë qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij... ”.*

E drejta për një proces të rregullt ligjor, në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qëndron vetëm tek veprimtaria e organeve gjyqësore, pasi ajo fillon dhe nuk mund të përjashtohet edhe në veprimtarinë administrative të organeve të administratës publike me rastin e respektimit të detyrimit të sanksionuar në nenin 142, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se : *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”*

Në funksion të dispozitave kushtetuese dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore në të cilat parashikohen të drejtat dhe detyrimet e organit të caktuar me ligj, në procesin e ekzekutimit.

Ndër aktet ligjore më të rëndësishme që garantojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përveç dispozitave përkatëse të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Penal, përmëdim dhe Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, dhe atë nr.10031, datë 11.12.2008 *“Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat”* ku përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Organet e administratës publike në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Shërbimin e Përmbarrimit Gjyqësor. Detyrimi për bashkëpunim, sanksionohet jo vetëm në nenin 523 të K.Pr.C., por dhe në një numër aktesh të tjera nënligjore dhe ligjore siç janë:

Vendimi i KM nr.563, datë 14.07.2010

*“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarrimor me agjensinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarrimit”.*

Udhëzimi i përbashkët i MD dhe MF nr. 3880/3, datë 03.06.2011

*“Për procedurat e bashkëpunimit të shërbimit të përmbarrimit gjyqësor shtetëror me policinë e shtetit”.*

Ligji nr.8471, datë 08.04.1999

*“Për nxjerrjen e detyrimeve dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”*

Ligji nr.8472, datë 08.04.1999

*“Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë e juridikë nga shitja e pasurisë apo transaksioneve të pronësisë”*

Ligji nr.8537, datë 18.10.1999

*“Për barrët siguruese”, i ndryshuar.*

Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998

*“Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.*

Ligji nr. 8894, datë 14.05.2002

*“Për Agjensinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar.*

Ligji nr.8347, datë 18.05.1998

*“Për një ndryshim në ligjin nr.8227, datë 30.07.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8215, datë 09.05.1997*

*“Për kontrrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”*

Vendimi i KM nr.443, datë 16.06.2011

*“Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS).*

Vendimi i KM nr. 335, datë 02.06.1998

*“Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”*

Udhëzimi i KM nr.2, datë 08.05.2009

*“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”*

Urdhëri i MD nr. 3847, datë 08.05.2009

*“Për delegimin e kompetencave Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”*

Udhëzim i përbashkët i MD dhe MF nr. 13, datë 12.02.2009 : *“Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë, për shpërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.*

Udhëzimi i përbashkët i MD dhe MF nr. 1240/5, datë 15.09.2009 :

*“Përcaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”.*

Urdhëri i MD nr. 4846/18, datë 20.09.2010

*“Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes e administrimit të vulave të përmbartuesve gjyqësor privatë”.*

Udhëzimi i MD nr. 4846/33, adtë 03.11.2010

*“Për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit pas çrregjistrimit të përmbaruesit gjyqësor privat” etj.*

Pavarësisht këtyre rregullimeve, përsëri situata paraqitet problematike.

Referuar nenit 2 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, misioni për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv i është ngarkuar Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor i cili funksionet e veta i kryen nëpërmjet përmbaruesve gjyqësor. Parimi i ligjshmërisë, objektivitetit si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, si parime bazë të punës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në një numër jo të vogël të rasteve të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk respektohen me rigorozitet prej këtij Shërbimi, si dhe prej debitorit ose personave të tretë të cilët sipas urdhërit të ekzekutimit apo ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Veprimtaria e përmbaruesve gjyqësor në pjesën më të madhe të rasteve (ankesave) të shqyrtuara dhe atyre që janë në shqyrtim prej Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk karakterizohet nga profesionalizmi dhe paaënësia në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv. Përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror për drejtimin dhe kontrollin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet të jenë më të mëdha dhe efikase.

Nëpërmjet këtij Raporti të Veçantë, synojmë sensibilizimin për situatën aktuale në të cilën ndodhet sot procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv, rritjen e përgjegjshmërisë së organeve që kanë për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, respektimin e parimeve mbi të cilat mbështetet puna e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor në procesin e ekzekutimit, ushtrimin e përgjegjësive prej organit përfaqësues të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, si dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, sikurse parashikohet në nenin 9 të K.Pr.A., prej institucioneve dhe organeve debitore apo të treta në procesin e ekzekutimit.

## **2. Problematikat e hasura në veprimtarinë e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.**

Angazhimi i Qeverisë për të përfunduar ekzekutimin e gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë (titujve ekzekutiv) të dhëna në vite, sipas të

cilëve është vendosur detyrimi i institucioneve buxhetore të paguajnë detyrime në të holla apo të kryejnë përmbushjen e një veprimi të caktuar ndaj subjekteve të ndryshëm gjyqfitues, nuk është në nivelin e angazhimit të marrë. Pra, problemi i mosekzekutimit të titujve ekzekutiv mbetet edhe sot një nga problemet e përsëritura me të cilin është ndeshur dhe ndeshet Institucioni i Avokatit të Popullit.

Referuar ankesave që i janë adresuar Avokatit të Popullit, rezulton se në mospërputhje me parashikimet e akteve ligjore si dhe atyre të nxjerra në funksion të tyre, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetror, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, me rastin e mospërmbushjes së detyrimit në mënyrë vullnetare prej palës debitore, nuk kryen në mënyrë aktive veprimet përmbartimore të cilat do të mund të sjellin ekzekutimin e detyrueshëm të tyre, duke mos luajtur në këtë mënyrë rolin vendimtar që i takon në procesin e ekzekutimit. Në shumicën e ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet lehtësisht se, shteti nuk ka marrë përsipër në mënyrë vijuese dhe rast pas rasti, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në procesin e ekzekutimit se, ato do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë titujt ekzekutiv. Ky qëndrim, të drejtën për të pasur akses në gjykatë, për subjektet ankues, e shndërron në iluzion, për faktin e pazbatueshmërisë së titullit ekzekutiv për një kohë tepër të gjatë, ashtu sikundër konkludon edhe Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2011, kur ka gjykuar dhe pranuar kërkesat e tetë subjekteve të ndryshëm, me objekt të njëjtë : ” *Konstatimin e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*”.

Tre nga tetë kërkuarit, përpara se t'i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese me objektin e sipërcituar, ashtu siç ju kemi raportuar edhe në Raportin Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011, kanë kërkuar ndërhyrjen e Institucionit tonë pranë organeve kompetente të ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, për rivënien në vend të së drejtës së shkelur.

**a) Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku institucionet shtetërore janë debitore.**

Procesi i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata publike shqiptare, veçanërisht kur prek të drejtat e njohura të individit, krijon një raport që shkon në përpjestim të zhdrejtë me shkallën e besimit të qytetarëve tek shteti i tyre. Kjo ka qenë një ndër arsyet kryesore pse Institucioni i Avokatit të Popullit që në muajt e parë të veprimtarisë së tij

në vitin 2000 e deri më sot, ka evidentuar mjaft ankesa dhe ka bërë publik faktin se ka qindra vendime gjyqësore, me faturë financiare të konsiderueshme të cilën shteti shqiptar, i përfaqësuar nga institucione qendrore dhe lokale i ka borxh shtetasve të tij. Ky borxh vetëm për shkak të mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë nga ana e autoritetve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e tyre, rrit faturën financiare nga dita në ditë për shkak të mospërbushjes së tij që në momentin e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor. Është fjala për ato vendime gjyqësore të formës së prerë sipas të cilave është vendosur për pagimin e detyrimit financiar deri në kryerjen e një veprimit të caktuar nga ana e institucionit buxhetor debitor. Shqetësuese është kjo situatë veçanërisht kur dhe organet më të larta të administratës publike nuk kanë përmbushur dhe nuk përmbushin detyrimet e vendosura sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna në vitet e shkuara. Ankesat e qytetareve pranë nesh janë drejtuar për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritit, Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Prefekturës së Qarkut Durrës, Bashkisë Tiranë, AKKP-ve, Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, Fier, Mirditë, Korçë, zyrave të ALUIZN-it Vlorë, Lezhë, Këshillin e Qarkut Kukës, INUV-së, Qarku Dibër, INUK-së Tiranë, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave etj.

Në këto kushte është i nevojshëm ndërgjegjësimi i administratës publike lidhur me detyrimet e saj gjatë kryerjes së funksioneve të njohura me ligj, në zbatim të vendimeve të gjykatave, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor i cili bën të mundur përfundimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë ashtu siç duhet, efektiv dhe brenda një afati të arsyeshëm. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe inicimi i çështjes prej Institucionit të Avokatit të Popullit në nxjerrjen e aktit nënligjor, konform nenit 589 të K.Pr.C., nga Këshilli i Ministrave, për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit. Në bazë të kësaj ndërhyrje Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Udhëzimin nr. 02, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”*, botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, datë 28.09.2011. Ky akt në përmbajtje, ka përcaktim të cilat nuk vijnë në përputhje me dispozitat ligjore të K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv si dhe krijojnë premisa për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm. Për të

bërë të mundur ndryshimin e përcaktimeve të kryera prej Këshillit të Ministrave në aktin nënligjor, të sipërcituar, si dhe për të mundësuar nxjerrjen e një akti nënligjor në funksion të dispozitave ligjore që parashikojnë ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore, i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë, për dijëni Këshillit të Ministrave, me shkresën nr. K3/S8-6 Prot, datë 26.03.2012, ndryshimi i Udhëzimit nr. 02, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”*.

Nga shqyrtimi i rasteve ka rezultuar se institucionet buxhetore debitore, në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk kryejnë rast pas rasti, respektimin e nenit 20 dhe 21 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”* dhe se, në ato raste kur janë respektuar këto dispozita, nuk është bërë i mundur financimi nga buxheti i shtetit për sigurimin e fondeve për shlyerjen e detyrimeve ndaj personave privatë.

Po kështu, në kundërshtim me detyrimin e vendosur nga gjykata apo Komisioni i Shërbimit Civil, në disa raste, titullarët e institucioneve buxhetore debitore, kanë mbajtur qëndrim të papranueshëm në përmbushje të detyrimit për pagimin e pagave në favor të gjyqfituesve, duke dorëzuar në favor të tyre shuma modeste mujore në masën 5000 deri 10.000 lekë. Kjo *“zgjidhje”* e dhënë prej tyre, përveçse është sa 1/10 apo 1/15 e detyrimit mujor të vendosur e vijues, lejon sjelljen e dëmeve të rëndësishme për gjyqfituesin si dhe familjen e tij.

Nder rastet e trajtuara permendim:

Rasti me **nr. doculive 201201089**<sup>1</sup>, në të cilin shtetasi F.G. ankohej ndaj Universitetit Bujqësor të Kamzës për mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 6347, datë 28.07.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për të cilin po kjo Gjykatë kishte lëshuar dhe urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 3748 Akti, datë 06.12.2010, me objekt :

*“Detyrimin e palës së paditur Universiteti Bujqësor Kamëz, t’i paguajë palës paditëse F.G., pagat mujore, sigurimet shoqërore, si dhe çdo detyrim tjetër, që rrjedh nga kjo marrëdhënie pune, nga dita e ndërprerjes së saj datë 24.05.2007, deri në momentin e ekzekutimit të Vendimit nr.24, datë 10.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr.361, datë 24.03.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë”*.

Sipas Vendimit nr.24, datë 10.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr.361, datë 24.03.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, konstatohet të jetë vendosur për :

---

<sup>1</sup> Doculive, është programi i menaxhimit të rasteve nga institucioni i Avokatit të Popullit



*“Ndryshimin e Vendimit nr. 24, datë 11.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë, deklarimin si të pavlefshëm të Vendimit nr.15, datë 24.05.2007, të Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë, dhe kthimin e tij në punën e mëparshme.*

*Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 8 muajve.*

*Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit dhe pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës si dhe 3 paga si shpërblim për vjetërsi pune”.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Rektorit të Universitetit Bujqësor Kamëz, marrjen e masave për dorëzimin e detyrimit të vendosur. Në përgjigje të rekomandimit, Rektori, z. Fatos Harizaj, na ka bërë të ditur se do t'i paguaj detyrimin në masën 10.000 lekë në muaj gjyqfituesit, ndërkohë që detyrimi në të holla (pagë) për çdo muaj, shtohet përderisa nuk përmbushet dhe detyrimi për rikthimin e ankuesit F.G. në detyrën që ka pasur.

Rasti me **nr. 201201089**, shtetësja T.Q. ankohet ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për mosekzekutimin e Vendimit nr.9, datë 10.03.2010, të Komisionit Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin nr. 63, datë 14.07.2010 dhe për të cilin po kjo gjykatë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 78, datë 16.09.2010, me objekt :

*“Shfuqizimin e aktit administrativ nr.6959/2, datë 18.09.2009 të Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit në METE, si të pabazuar në ligj e prova. Rikthimin e ankueses T.Q. në detyrën që ka pasur më parë, atë të Inspektores në Drejtorinë e Auditit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.*

*Pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi...”.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka kërkuar shpjegime Sekretarit të Përgjithshëm, z.Ilirjan Muho, rreth shkaqeve të cilat kanë justifikuar dhe justifikojnë mospërmbushjen e detyrimeve të vendosur sipas Titullit Ekzekutiv të lartëpërmendur. Në përgjigje të kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm, z.Muho, për detyrimin e pagimit të pagës në favor të gjyqfitueses nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi, informon dhe bën të mundur vënien në dispozicion të një kopjeje të Urdhërit të Ministrit nr. 700, datë 28.09.2011, sipas të cilit urdhërohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për kryrjen e pagesës në masën 10000 lekë në muaj gjyqfitueses

T.Q., për periudhën Gusht-Dhjetor 2011, në zbatim të urdhërit të ekzekutimit nr. 78, datë 16.09.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Në shqyrtimin e rastit me nr. **201200244**, shtetasi V. Xh, ankohej ndaj Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, për mosekzekutimin e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, me Vendimin nr. 1085, datë 29.04.2011, për të cilin po kjo Gjykatë ka lëshuar dhe urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 383, datë 30.05.2011, me objekt :

*“1-Pranimin e kërkesëpadisë me paditës V Xh, palë të paditura 1.Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Komunikimit) Tiranë, 2. Drejtoria e Shërbimit Pyjor Devoll, me objekt : Detyrimi i palës së paditur të paguaj shpërblimin dhe dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës me pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit, me pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme si dhe me pagën e një viti si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës.*

*2. Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditësit V. XH ;*

*8(tetë) muaj pagë dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës në masën 455704 lekë.*

*3(tre) muaj pagë për mosrespektim të afateve të njoftimit në shumën 170889 lekë.*

*2(dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës të zgjidhjes së kontratës në shumën 113926 lekë*

*16.5 muaj pagë për shpërblimin e vjetërsisë në punë në shumën 939889 lekë*

*Gjithësej në shumën 1680408 lekë*

*Shpenzimet gjyqësore në masën 48000 lekë në ngarkim të palëve të paditura”.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i kërkoi shpjegime palës debitore, rreth shkaqeve të cilat justifikonin mospërmbushjen e detyrimeve të vendosura sipas titullit ekzekutiv të lartpërmendur. Në përgjigje të kërkesës, Sekretarja e Përgjithshme, zj. Mimoza Vokshi, për detyrimin e pagimit të pagës në favor të gjyqfitueses nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi, informon se shlyerja e detyrimit do të kryhet duke paguar shumën prej 5000 lekë në muaj gjyqfituesit deri në dorëzimin e detyrimit prej 1.752.408 lekë.

Ky qëndrim i mbajtur në procesin e ekzekutimit të titujve të sipërcituar ekzekutiv, nuk mund të vlerësohet i mjaftueshëm e në përputhje me dispozitat ligjore për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, për faktin se nuk ekziston asnjë arsye apo pengesë në ekzekutimin e plotë e të menjëhershëm të detyrimit për pagimin e pagës në favor të gjyqfituesve. Mosbërja e mundur e materializimit të së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore prej ankuesve, mundëson sjelljen e dëmeve të rëndësishme për ta dhe familjet e tyre, situatë e cila nuk mund të zgjidhet me dorëzimin e një shume mujore modeste nga ana e institucioneve buxhetore debitore.

Nisur nga parashikimi i nenit 517 të K.Pr.C. ku thuhet se :

“... ”

*Me kërkesën e debitorit, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethanat e tjera të çështjes pasi dëgjon edhe kreditorin, mund të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste... ”*, kuptohet se dorëzimi i detyrimit në mënyrën e përcaktuar nga titullarët e institucioneve buxhetore debitore, nuk gjen mbështetje ligjore. Për rrjedhojë, marrja e masave për dorëzimin tërësisht të detyrimit financiar është i vetmi veprim që duhet të kryhet në përmbushje të detyrimit të vendosur.

Në shqyrtimin e rastit me nr. **doculive 201001792**, ankuesi N. B ankohej ndaj Ministrisë së Brendshme për moszekzekutimin e Vendimit nr. 129, datë 04.04.2007, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, sipas të cilit është vendosur për lënien në fuqi të Vendimit nr. 223, datë 04.04.2006 i Komisionit të Shërbimit Civil, me objekt midis të tjerave: *”Detyrimin e Sekretarit të Përgjithshëm për t’i ofruar ankuesit Nikoll Bunjaj pozicionin Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile”*.

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve. Deri më sot refuzohet kthimi i përgjigjes për rekomandimin e dhënë.

Në shqyrtimin e rastit me nr. **doculive 200900246**, ankuesja A. A ankohej ndaj Ministrisë së Drejtësisë për moszekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 94, datë 14.07.2008, të dhënë prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, për të cilin, po kjo Gjykatë, ka lëshuar dhe urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 136 Akti, datë 18.12.2008.

Sipas Vendimit Gjyqësor nr. 94, datë 14.07.2008, të Gjykatës së Apelit, Tiranë, me anë të të cilit është vendosur për lënien në fuqi të Vendimit nr. 46, datë 12.02.2008, të Komisionit të Shërbimit Civil, është vendosur për :

*“Rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, Drejtore e Qendrës Publikimeve Zyrtare dhe kryerjen e pagesës për ankuesen nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi”.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, qe prej vitit 2009 i ka rekomanduar Ministrit të Drejtësisë, marrjen e masave për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr.94, datë 14.07.2008, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, sipas të cilit është vendosur për lënien në fuqi të Vendimit nr.46, datë 132.02.2008, të Komisionit Shërbimit Civil. Deri më sot refuzohet kthimi i përgjigjes për rekomandimin e dhënë.

Në rastin me **nr. doculive 201100567**, ankuesi B. Z ankohej ndaj Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit për moszekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 2798, datë 18.04.2007, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin po kjo gjykatë, ka lëshuar dhe urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 2249, datë 28.07.2009.

Sipas Vendimit Gjyqësor nr. 2798, datë 18.04.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin nr. 1071, datë 30.05.2008, është vendosur për : *“Detyrimin e palës së paditur Avokatura e Përgjithëshme e Shtetit të dëmshpërblejë palën paditëse Besnik Zeneli me pagën e 12 muajve për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës.*

*Detyrimin e palës së paditur Avokatura e Përgjithshme e Shtetit t’i paguaj palës paditëse pagën e dy muajve për mungesë të zbatimit të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës dhe dy muaj pagë për afatin e njoftimit”.* Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Zyrës së Përmbarimit Tiranë, kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv si dhe ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor të bëj të mundur shqyrtimin e rekomandimit të dhënë Zyrës së Përmbarimit Tiranë. Deri më sot refuzohet kthimi i përgjigjes për rekomandimin e dhënë.

Në rastin me **nr. doculive 201000274**, ankuesi Z. D. ankohej ndaj Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit (sot- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit) për moszekutimin e Vendimit Nr.38, datë 20.02.2001 të Komisionit Shërbimit Civil, ndryshuar me Vendimin Nr. 39, datë 15.05.2002 nga Gjykata e Apelit Tiranë, dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me Vendimin Nr. 1912, datë 16.12.2003, me objekt : *“Pranimin e ankesës së z.Zarif Dervishi, duke shfuqizuar Vendimin nr.6208 prot, datë.03.12.2001 të Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, për moskonfirmimin si nëpunës civil, në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të*

*Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizimit, dhe kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.*

*Pagimin e pagave për gjithë kohën e qëndrimit pa punë, padrejtësisht”.*

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Ministrit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve. Deri më sot refuzohet kthimi i përgjigjes për rekomandimin e dhënë.

Për gjithë rastet e shqyrtuar apo në shqyrtim prej Institucionit të Avokatit të Popullit, pas marrjes së shpjegimeve dhe informacionit, rast pas rasti prej palës debitore, apo zyrave të përmbarimit, është konstatuar se mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj, për palët në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vjen si rezultat i :

- 1- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë dhe objektivitetit, nga ana e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror (ShPGjSh), përmbaruesit gjyqësor të çështjes, parime të cilat janë të sanksionuara në nenin 4 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, i ndryshuar. Shkelja e parimeve në fjalë, në rastin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt, “Detyrim për pagim në të holla prej institucioneve buxhetore”, apo “Detyrim për kryerjen e një veprimi të caktuar”, vjen si rezultat i : i) Moskryerjes së veprimtarisë nga ana e DPShPGjSh dhe atij privat në përputhje të plotë dhe konsekuente me parashikimet e bëra në nenet 517, paragrafi dytë, 527, 583, 589 dhe 606 të K.Pr.C., ii) Ushtrimi në mënyrë të padrejtë e të parregullt prej zyrave të përmbarimit, përmbaruesve gjyqësor të çështjes, i së drejtës për të refuzuar kryerjen e veprimeve përmbarimore në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doculive 201000697, nr.201000697) pa u ndodhur në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore, neni 610, iii) Pushimi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doculive 201001284, rasti me nr.doculive 201101285, nr. 201100365, nr.201100365) pa u ndodhur në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore, neni 616 të K.Pr.C., iv) Shfaqja e mungesës së aftësive profesionale në procesin e ekzekutimit (rasti me nr. doculive 20100697, nr.201101032, nr.201100802, nr. 201100715, nr.201100365.)
- 2- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të institucioneve buxhetore debitore apo organeve eprore financiare të

tyre, sikurse parashikohet në nenin 531 të K.Pr.C si dhe nenet 20 dhe 21 të Ligjit nr.8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

- 3- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të degëve të thesarit në rrethe, siç sanksionohet në nenin 581, 583 dhe 589 të K.Pr.C. në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv sipas të cilëve rezultojnë debitor institucione buxhetore.
- 4- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të palëve të treta (organit shtetëror) në procesin e ekzekutimit, siç parashikohet në nenin 523 të K.Pr.C. (rasti me nr.doculive 201101920)

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të sipërcituara, Institucioni i Avokatit të Popullit, për situatat në të cilat janë ndodhur dhe ndodhen çështjet në procesin e ekzekutimit, i ka rekomanduar zyrave të përmbartimit, përmbartuesve gjyqësor të çështjes, palës debitore si dhe personave të tjerë, kryerjen e veprimeve të caktuara të cilat bëjnë të mundur materializimin e së drejtës për subjektet gjyqësive, si dhe rivënien në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Nisur nga qëndrimet e mbajtura prej ShPGjSh, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt : “Detyrim për pagim në të holla prej institucioneve buxhetore”, apo “Detyrim e tyre për kryerjen e një veprimi të caktuar” të krijohet bindja e “dorëzimit” të këtij Shërbimi në kryerjen e procedurave për ekzekutim të detyrueshëm ndaj organeve dhe institucioneve shtetërore si dhe lënien e misionit të ekzekutimit në vullnetin e institucioneve buxhetore debitore, kjo për faktin se ShPGjSh ose nuk kryen rast pas rasti veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, ose kryen në mënyrë të përsëritur, të panevojshme e të paligjshme, veprime përmbartimore lajmëruese ose urdhëruese (rasti me nr.doculive 201001089, nr.201000736, nr.201100729, 201100109).

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të sipërpërmendura, Institucioni i Avokatit të Popullit, rast pas rasti, ka rekomanduar ose marrjen e masave ligjore prej organeve dhe institucioneve debitore për përmbartjen e detyrimit të vendosur ose ka rekomanduar ShPGjSh kryerjen e veprimeve të caktuara përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, si, vendosjen e masës së sekuestros mbi llogarinë e institucionit buxhetor debitor, në të gjithë zërat (artikujt) e llogarisë në thesar të palës debitore, gjorbitjen e titullarëve të palës debitore ose çdo personi tjetër, të cilët në procesin e ekzekutimit kanë refuzuar, kryer në mënyrë të parregullt,

mosrespektuar afatet, si dhe kryer të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës ose ligjit janë detyruar.

Reagimi i institucioneve buxhetore ndaj rekomandimeve për marrjen e masave në përmbushjen e detyrimit të vendosur, për rastet në fjalë, ka qenë ose premtim për ekzekutim të tij në të ardhmen (si në rastin me nr.doculive 201001445) ose është heshtur për kthimin e përgjigjes në dhjetra raste, (si në rastin me numër doculive 20100736, nr. 201000274, nr. 200902027, nr.200901831, nr. 201001594, nr. 201001466, nr. 201001311, nr. 201001284, nr. 201001089, nr. 20100697, nr. 201101285, nr. 201100729, nr. 201100655, nr. 201100567, nr. 201100563, nr. 201100086, nr. 201001682), duke shkelur në këtë mënyrë detyrimin për t'iu përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit, në respektim të parashikimit të kryer në nenin 22 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

#### **b) Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, e bën mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm në rezultat. Nëqoftë se organet e administratës refuzojnë ose nuk veprojnë për ekzekutimin e një vendimi, garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga të cilat përfitojnë palët gjatë fazës gjyqësore të procedurës, do të humbisnin çdo arsye të ekzistencës së tyre. Nga trajtimi i anesave të individëve të ndryshëm drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se institucionet e kanë jo vetëm të vështirë të pranojnë se nga pikëpamja administrative mund të ngarkohen me përgjegjësi, por aq më keq kur është rasti, që përgjegjësia administrative e institucionit është e ndarë nga ajo e personit që eventualisht e përfaqëson atë. Për më tepër ata e kanë të vështirë të përgjigjen për akte të kryera nga institucioni që ata përfaqësojnë përpara se ata të zgjidheshin apo emroheshin si përfaqësues i tij (suksedimi i përgjegjësise administrative). Dhe për pasojë vijme në situata si ajo e çështjeve "Qufaj & Co shpk kunder .Shqipërisë", "Gjon Boçari kunder Shqipërisë", "Vrioni & tjerë kunder Shqipërisë" etj, ku kërkesave të individëve apo personave juridik privat, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg i është përgjigjur pozitivisht, duke ndëshkuar shtetin shqiptar për shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe nga legjislacioni i brendshëm. Dhe ndëshkimi ka një faturë financiare që paguhet nga taksapaguesit shqiptar.

Një nga rastet më pikante të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë e cila i është bërë prezent institucionit të Avokatit të Popullit, duke u kërkuar ndërhyrja e këtij të fundit, është ajo e familjes Boçari, rast që edhe pse u gjykua dhe pranua kërkesa e kësaj familje nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ende nuk ekzekutohet nga Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Konkretisht, në vitin 1994, familja Boçari bazuar në ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar aplikoi pranë ish Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. Kjo e fundit me Vendimin nr. 109, dt. 26.08.1996 vendosi të njohë si pronarë trashëgimtarët e ish pronarëve mbi një sipërfaqe toke të tjetërsuar në truall prej 47 ha të ndodhur në vendin “Shkalla” të Ujit të Ftohtë, Vlorë, kthimin fizik të disa sipërfaqeve dhe njohjen e të drejtës së parablerjes për objektet shtetërore të ndërtuara mbi këtë truall.

Në datën 09.04.1999, u krye regjistrimi në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, por me urdhër të Regjistruesit të Zyrës, në datën 11.06.1999, u fshi nga regjistri përkatës, në kundërshtim me Ligjin “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Vendimi nr. 109, dt. 26.08.1996 i Agjensisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, u është dorëzuar të interesuarve me mangësi materiale, të cilat në bazë të nenit 120 të Kodit të Proçedurave Administrative, duhet të korigjoheshin nga vetë organi administrativ, Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, pa prekur përmbajtjen e tij.

Meqë rruga administrative nuk funksionoi, të interesuarit, trashëgimtarët Boçari, ju drejtuan proçesit gjyqësor, proces i cili përfundoi me Vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr 502.dt 6.3.2003, i cili vendosi ndër të tjera : *“Detyrimin e KKP të Pronave Vlorë të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji, në lidhje me kërkesën e paditësit Gëzim Boçari. Prishjen e vendimit nr.295, dt.25.05.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.195, datë 06.02.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për pjesën që rrëzon padinë me objekt : kundërshtim vendimi nr.63, datë 07.10.1997 të KKK të Pronave Vlorë dhe pushimin e gjykimit për këtë pjesë”*.



Ankuesi filloi procedurat përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 502, dt 6.3.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por zvarritjet në procesin e ekzekutimit e detyrueshëm ishin shkak që legjitimoi ankimin e gjyqfituesve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ndërkohë agjensitë rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave u suprimuan me ligj dhe të drejtat e detyrimit e tyre i kaluan Agjensisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë.

Në Vendim (Ankimi nr.10508/02), për çështjen “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, datë 31.93.2008, Gjykata e lartpërmëndur në pikat 11, 52, 54, 100 dhe 101, midis të tjerave, shprehet : *"Se kompetenca për korrigjimin formal të dokumentave të Komisionit i takonte gjykatave.... gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë nr 502.dt 6.3.2003 i ngarkoi Komisionit të Vlorës detyrën për të lëshuar një vendim të ri vis-a vis, për ankuesit konform me kërkesat formale të ligjit...prandaj, ajo vlerëson se pala Shqiptare duhet të sigurojë nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase, pala përgjegjëse duhet t'i paguajë çdo ankuesi, brënda tre muajsh nga data kur vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44/ 2 të Konventës, shumë prej 7 000 euro në lidhje me dëmin moral për shkeljet e konstatuara ...,"*

Qeveria Shqiptare ka ekzekutuar në kohë dënimin monetar, por nuk ka ekzekutuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 502. dt 6.03.2003, siç kërkohet në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këto rrethana, ankuesi, G. B., relatoi pranë Këshillit të Evropës dhe Avokatit të Popullit pavërtetësinë e raportimit të qeverisë shqiptare në Këshillin e Evropës, se vendimi i Gjykatës së Lartë dhe Vendimi i Gjykatës së Strasburgut nr.10508/02, ishin ekzekutuar dhe kërkoi ndërmjetësimin e Institucionit tonë për ekzekutimin nga ana e Agjensisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të vendimit gjyqësor nr 502, datë 6.3.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe Vendimin e Gjykatës së Strasburgut nr.10508/02. Një fakt i tillë përmendet dhe në Raportin Vjetor 2010 për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të kësaj gjykate<sup>2</sup>.

Për të hedhur dritë mbi këtë problem fillimisht kemi kërkuar shpjegime, nga AKKP-ja dhe nga Avokatia e Përgjithshme e Shtetit. Me shkresën nr. 3224/1 datë 13.07.2011, AKKP-ja Qëndrore njofton Avokatitn

---

<sup>2</sup> Supervision of the execution of judgments of European Court of Human Rights, 4-th annual report 2010

e Popullit, se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 502 datë 06.03.2003, është ekzekutuar me vendimet e AKKP-së Tiranë nr. 414 dhe nr. 415 dt 22.04.2008, me të cilat, kjo e fundit ka vendosur: “...të mos njohë të drejtën e pronësisë subjektiv të shpronësuar...”.

Vendimet e sipërcituara nuk janë ekzekutim i vendimit të Gjykatës të Lartë dhe as i vendimit të Gjykatës së Strasburgut. Me to, faktikisht sipas gjykimit tone, është rrëzuar një Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg për familjen Boçari, si dhe vendimi administrativ nr.109, datë 27.09.1996 i ish-KKKP-së Vlorë.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë nr 502, datë 6.3.2003, nënvizohet, se : “...KKK e Pronave Vlorë ka nxjerrë aktin administrativ, vendimin nr.109, datë 27.09.1996, me të cilin i njihet dhe i kthehet trashëgimlënësve të paditësit Gëzim Boçari një sipërfaqe toke-truall me sipërfaqe 6 100 m2 në vendin e quajtur “Uji i Ftohtë”, Vlorë (Jonufër). Vendimi i sipërm i KKK të Pronave është një akt administrativ, të cilit i mungon forma, ka mungesë të nënshkruesve të anëtarëve të komisionit, etj. Me padinë objekt shqyrtimi kërkohet nga KKK të Pronave Vlorë dhënia e formës ligjore të vendimit, duke ju përgjigjur kërkesave së tij drejtuar KKK të Pronave, për pronën objekt kërkimi.....Vendimi i Gjykatës së Rrethit dhe e Apelit që ka rrëzuar padinë e paraqitur nga Gëzim Boçari, janë në zbatim të keq të dispozitave të KPr.Civile që parashkojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve Administrative...nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të Kodit të Proçedurës Administrative që bëjnë fjalë për aktet administrative, formën e tyre, qëllimin e aktit, arsyetimin e tij, nenet 105, 106 e vijues. Këto dispozita janë të detyrueshme për tu zbatuar nga organi administrativ, që nxjerr aktin administrativ dhe vërteton përfundimin e proçedimit administrativ, i cili sipas nenit 99 të Kodit të Proçedurave Administrative përfundon me marrjen e vendimit nga organi përkates... Sa më sipër, kolegji çmon se me të drejtë pala paditëse i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, meqënëse nuk ka mundur të realizojë të drejtat e tij në rrugë administrative. Sipas nenit 339 të K.Pr.Civile e neneve 105, 106, etj, të Kodit të Proçedurave Administrative, organet e administratës të caktuara me ligj për nxjerrjen e vendimeve sipas ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave..” janë të detyruar të nxjerrin vendim në formën e kërkuar nga ligji, në lidhje me kërkesën e paditësit Gëzim Boçari, për padinë objekt kërkimi”.

Vendimet e AKKP-së Tiranë nr. 414 dhe nr. 415 dt 22.04.2008, me të cilat ajo ka vendosur: “**...të mos njohë të drejtën e pronësisë subjektivit të shpronësuar...**” kanë treguar se është lexuar dhe interpretuar gabim vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 502, datë 06.03.2003 duke i ndryshuar përmbajtjen dhe thelbin e tij. Për këto arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit pas shqyrtimit të dokumentacionit, nisur nga vlerësimi në tërësi i rastit dhe nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë në procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në përputhje me Nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, i rekomandoi Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin përfundimtar të vendimit gjyqësor të trajtuar më lart. Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave lidhur me rekomandimin, na u bë me dije me shkresën e tij nr.4074/1 Prot., datë 12.12.2011 dhe ishte i njëjtin qëndrimin, si pesë vitet e kaluara, që vendimi është ekzekutuar.

Në raportimin e bërë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në Komitetin pranë Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në fund të Prillit 2009, është referuar se kjo çështje është në shqyrtim. Kjo rezulton nga shkresa me nr.8079/1 Prot. datë 22.10.2009 e Drejtorisë së Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, drejtuar Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ku mes të tjerave theksohet, që : *“.....është e domosdoshme që Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, të veprojë me urgjencë për zbatimin e këtij vendimi, pasi për çdo vendimmarrje që ka të bëjë me zbatimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shteti shqiptar është i detyruar të raportojë pranë Komitetit të Këshillit të Ministrave, të Këshillit të Evropës.....shteti shqiptar ka raportuar së fundmi në Prill 2009, se çështja është në shqyrtim, duke bërë të qartë se nuk është më e mundur të raportohet sërish e njëjta gjë, pasi në të kundërt shteti shqiptar rrezikon të penalizohet, duke u kritikuar ashpër nga Komiteti i Këshillit të Ministrave, si dhe rrezikon moszbatimin e parimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit”*.

Duke qënë të bindur në bazueshmërinë e pretendimeve të ankuesit, kemi kërkuar ndërhyrje institucionale nga Ministri i Drejtësisë për ekzekutimin e Vendimit nr.10508/02, 23.10.2007 të Gjykatës Evropiane të

të Drejtave të Njeriut, në favor të familjes Boçari. Akoma nuk kemi përgjigje për këtë rast.

Nisur nga trajtimi që zyra jonë i ka bërë ankesës së familjes Boçari, dhe nga çështjet e përfunduara së shqyrtuari nga Gjykata Evropiane e Strasburgut, ku shteti shqiptar është ndëshkuar, rezulton se për 20<sup>3</sup> nga 27 raste gjithësej, janë nxjerrë vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e detyrimit në të holla të vendosur nga GJEDNJ, por në rastin kur është kërkuar rregullimi i akteve administrative të nxjerra nga organet përkatëse të administratës publike, vendimi ka ngelur i paekzekutuar (Boçari kundër Shqipërisë).

**c) Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt detyrimin për dorëzimin e një sendi të caktuar sipas nenit 602 e vijues të KPrC.**

Problematike paraqitet situata dhe në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv sipas të cilëve është vendosur për lirim e dorëzim sendi, duke sjell në këtë mënyrë zvarritjen e procesit të ekzekutimit si dhe mosdhënien e mundësisë për gëzimin nga ana e gjyqfituesit të së drejtës së pronësisë mbi pasurinë objekt ekzekutimi.

Në shqyrtimin e rastit me **nr. doculive 200902027**, ankuesi H. Z ankohej ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 1358, Dt 26.12.2006, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë., me objekt midis të tjerave : *“Detyrimin e palës së paditur Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rektorati i Universitetit të Tiranës të kryejnë lirim dhe dorëzimin e ish-konviktit “Naim Frashëri”, ndodhur në rrugën e “Kavajës” si dhe detyrimi për pagimin e qeras nga i padituri kundërpaditës prej datës 04.10.2002 në masën 504.720 lekë në muaj”*.

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin e detyrueshëm si dhe vendosjen e sanksioneve ligjore ndaj personave që nuk kryejnë veprimet përkatëse për përmbushjen e detyrimit ligjor të përcaktuar në Vendimin Gjyqësor nr. 1358,

---

<sup>3</sup> VKM502, datë 30.06.2005; 542, datë 22.08.2007; 250, datë 27.04.2007; 784, datë 04.06.2008; 252, datë 2010; 1293, datë 27.09.2008; 712, datë 23.06.2009; 258, datë 12.03.2009; 853, datë 05.08.2009; 437, datë 09.06.2010; 487, datë 13.07.2011; 1428, datë 22.10.2008; 691, datë 18.06.2009; 1028, datë 08.10.2009; 1027, datë 08.10.2009; 1201, datë 27.08.2008; 813, datë 13.10.2010; 282, datë 06.04.2011; 229, datë 07.04.2010; 318, datë 21.04.2011.

datë 26.12.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Per kete rekomandim nuk kemi asnje pergjigje ndonese kane kaluar të gjitha afatet ligjore.

**ç) Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt detyrimin për kryerjen e një veprimi të caktuar sipas nenit 605 e vijues të KPrC**

Në qëndrimin që mbahet nga autoritetet publike që kanë detyrimin për kryerjen e veprimeve të caktuara për realizimin e ekzekutimit të detyrimit të vendosur me një vendim gjyqësor të formës së prerë, konstatohet se nga ana e këtyre autoriteteve shkelet parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor pasi nuk realizohet e drejta e fituar në rrugë gjyqësore e gjyqfituesve.

Konkretisht përmendim rastet e trajtuara nga zyra e Avokatit të Popullit si më poshtë:

Në shqyrtimin e rastit **me nr. doculive 201200026**, ankuesi H. P etj prezantoi shqetësimin për mospërmbarimin e detyrimit nga ana e Ministrisë së Brendshme sikurse ishte vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 10006, datë 19.11.2008, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 118, datë 28.01.2010, me objekt ; *”Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme për të nxjerrë aktin administrativ përkatës të tij për shqyrtimin dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes së 168 familjeve të Fshatit Bicaj, Rrethit Kukës, të cilët kanë mbajtur dhe strehuar familjet kosovare gjatë muajit Prill-Maj të vitit 1999, sipas listës bashkëngjitur Vendimit nr.89, datë 21.06.2005 të Këshillit të Komunës Bicaj”*.

Në procesin e shqyrtimit të ankesës, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, marrjen e masave për nxjerrjen e aktit administrativ përkatës. Pergjigjia lidhur me këtë rekomandim, na është bërë e ditur në datën 28 maj 2012 (në kapërcim të afateve të parashikuara nga ligji).

**- Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

Paraprakisht duhet evidentuar fakti, se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme, si prishje objektesh, lirim dhe dorëzim sendi të paluajtshëm, ekzekutimin e pjestimit gjyqësor e të tjera, kërkojnë nga shërbimi përmbarimor kujdes të veçantë, njohjen e zbatimit shumë të mirë të ligjit material dhe procedurial

civil dhe interpretim korrekt të titullit ekzekutiv. Në të kundërt, propabiliteti për cënimin e të drejtave të pronës së debitorit ose personave të tretë mbetet i lartë. Dhe pranë nesh janë prezantuar raste kur debitorët e një procedimi përmbarimor ankohen, se veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer në dëm të tij, në kapërcim të urdhërimit gjyqësor. Askush nuk e pengon të udhëzojë kreditorin t'i drejtohet gjykatës për ndreqjen e gabimeve ose plotësimin e vendimit. E gjejmë me vënd t'u referohemi disa rasteve tipike si më poshtë:

Në trajtimin e ankesës së shtetasit V. A, i cili ankohej ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, për moszekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 305 datë 20.06.2007, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Mat, për të cilin po kjo Gjykatë ka lëshuar dhe urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 41, datë 07.09.2007, me obejkt :

*“Detyrimin e të paditurit Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, të kryej lëshimin e vërtetimit të pronësisë për efekt shitje të pasurisë të rregjistruar me nr. 105, viti 1993, nr.pasurie 6/78, Z.K.1326, sipas kartelës së pronësisë në favor të kreditorit V. A.”,*

Institucioni i Avokatit të Popullit për qëndrimin pengues të mbajtur prej ish-Regjistruesit të ZVRRPP Mat, z.Astrit Farruku, në vitin 2010, ka rekomanduar fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij për dhënien e masës disiplinore “Largim nga detyra”. Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Ministria e Drejtësisë, konfirmon dhënien e masës disiplinore ndaj tij “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”. Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimit ligjor të vendosur, mbi bazë të kallzimit të kryer nga Zyra e Përmbarimit Mat, Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 338, datë 23.03.2011, ka deklaruar fajtor ish-Regjistruesin e ZVRRPP Mat, për kryerjen e veprës penale, “Pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, duke e dënuar me gjobë në masën 200000 lekë.

Nga aktet e administruara, bashkëlidhur ankesës së shtetasit V. A, rezulton se, Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë) më datë 05.11.2010 ka ushtruar kontroll në ZVRRPP Mat, lidhur me pretendimet e ankuesit V. A. Në raport kontrollin e mbajtur, dhe dërguar ZQRRPP, Tiranë, me shkresën nr. 8562/3, datë 17.11.2010, i është rekomanduar ZVRRPP Mat, midis të tjerave, të vendosë në seksionin “E” të kartelës së pasurisë shënimin : “Kufizim i veprimeve mbi pasurinë, deri në plotësimin e mangësive në dokumentacion” si dhe në seksionin “D” të kartelës shënimin : “Dokumenti lëshohet në zbatim të Vendimit Gjyqësor nr.305, datë 20.06.2007.

Në kushtet e marrjes së konsideratë të rekomandimit të dhënë, rezulton se ZQRRPP, Tiranë, me shkresën nr. 4365//4, datë 26.11.2010,

drejtuar ZVRRPP Mat, ka kërkuar marrjen e masave në përputhje me rekomandimet e dhëna prej Ministrisë së Drejtësisë sipas raport kontrollit të mbajtur prej saj.

Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, në përmbushje të detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor nr. 305, datë 20.06.2007, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Mat, si dhe rekomandimeve të dhëna prej Ministrisë së Drejtësisë, ka bërë të mundur lëshimin e kartelës së pasurisë me shënimet të cilat nuk vijnë në përputhje për sa është vendosur nga Gjykata me vendimin gjyqësor nr. 305 datë 20.06.2007. Ndodhur në këto kushte Avokati i Popullit i ka rekomanduar Regjistruesit aktual të ZVRPP Mat, marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit të vendosur. Deri më sot mbahet qëndrim refuzues prej Regjistruesit të ZVRPP Mat, për kthimin e përgjigjes rreth këtij rekomandimi.

Tjetër rast është ai i shtetasit A. Sh. në të cilën ankohej ndaj Zyrës Përmbartimore Elbasan, lidhur me mosmarrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 1859 datë 16.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këtë vendimi është vendosur detyrimi i Z.V.R.P.P Elbasan, të kryej të gjitha procedurat përkatëse për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme. Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese ju drejtuam me një kërkesë për informacion Zyrës Përmbartimore Elbasan, lidhur me shkaqet e moszekutimit të këtij vendimi gjyqësor. Në përgjigjen e ardhur nga kjo zyrë vihemi në dijeni se nga ana e Z.V.R.P.P është refuzuar ekzekutimi i këtij vendimi dhe regjistrimi i pasurisë në emër të ankuesit pasi vendimi Nr. 525/2 datë 17.03.1995, i K.K.Pronave dhe planvendosja nuk plotësojnë kërkesat e nevojshme për t'u quajtur akte administrative si dhe dokumenti bazë që njih ankuesin si pronar nuk gjendet në arshivën e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Pas kësaj përgjigje menjëherë i rekomanduam Zyrës Përmbartimore Elbasan aplikimin e sanksioneve ligjore ndaj personave që bëhen pengesë në ekzekutimin e këtij vendimi si dhe Z.Q.R.P.P Tiranë të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të mësipërm dhënë në favor të ankuesit. Në përgjigjen e ardhur nga Z.Q.R.P.P Tiranë, vihemi në dijeni se pas materialit të administruar si dhe bazuar në ligjin Nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”, u urdhërua vazhdimi i procedurave të regjistrimit të pasurisë objekt i kërkesës së paraqitur nga ankuesi.

**d) Bashkëpunimi midis Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror.**

Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror nuk ka qënë në nivelin e duhur. Ky i fundit, në procesin e shqyrtimit të rekomandimeve të dërguara prej Institucionit të Avokatit të Popullit, apo kërkesave për të bërë të mundur dhënien e shpjegimeve dhe informacionit nga zyrat e përmbarrimit, nuk ka shprehur vullnet për bashkëpunim, qëndrim i cili jo vetëm ka shkelur detyrimin ligjor, sikurse parashikohet në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, por ka krijuar dhe premisat për mosushtrimin nga ana e tij të përgjegjësi, siç parashikohet në nenin 8 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”, i ndryshuar. Shfaqja e qëndrimit mosbashkëpunues prej DPSHPGjSh, i cili vjen ndesh me parashikimin e nenit 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, haset në rastet e poshtëshënuara :

- 1- **Nr. 201001466 Doc.** Në këtë rast i është kërkuar me shkresën nr. K2/A66-11 Prot, datë 22.07.2011, DPSHPGjSh, të bëj të mundur kthimin e përgjigjes për rekomandimin e dhënë Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, me shkresën nr. K2/I14-7 Prot, datë 08.02.2011. Deri më sot nuk është kthyer përgjigje apo të prezantohen shkaqet për mospërmbushjen e saj.
- 2- **Nr.201001115 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/B26-21 Prot, datë 09.06.2011, DPSHPGjSh, të marr nismën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbarruesit gjyqësor të çështjes, por përsëri haset i njëjti qëndrim refuzues për kthimin e përgjigjes.
- 3- **Nr.200902027 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/H20-9 Prot, datë 27.01.2010, Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë si dhe DPSHPGjSh, të vendosin sanksione ligjore në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 1358, datë 26.12.2006, si dhe të kryejnë veprimet për ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Deri më sot nuk kemi përgjigje prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë apo DPSHPGjSh.
- 4- **Nr.201100655 Doc.** Në këtë rast i është kërkuar DPSHPGj të bëj të mundur kthimin e përgjigjes lidhur me rekomandimin e dhënë Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, me shkresën nr. K2/E14-7 Prot, datë 04.07.2011. Deri më sot nuk kemi kthim përgjigjeje prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, apo DPSHPGj.



- 5- **Nr.201100567 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/B7-9 Prot, datë 23.06.2011, DPShPGj të bëj të mundur marrjen e nismës përfillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor i cili nuk ka kryer dhe nuk kryen veprimet përmbarimore të parashikuara në ligj në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 2798, datë 18.04.2007. Deri më sot nuk kemi përgjigje prej DPShPGj.
- 6- **Nr.201100086 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/A7-3 Prot, datë 06.04.2011, Zyrës së Përmbarimit, Tiranë, për dijëni DPShPGjSh, kryerja e veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor nr. 46, datë 12.02.2008, dhënë prej KSHC. Dhe ky rast rezulton të jetë pa përgjigje nga Zyra e Përmbarimit, Tiranë, apo DPShPGjSh.

Tjetër qëndrim i parregullt për të cilin është kryer rekomandimi përkatës është tërheqja e dosjeve përmbarimore prej Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, ndërkohë që zyra e përmbarimit, përmbaruesi gjyqësor i çështjes është duke kryer veprimet për ekzekutim të titullit ekzekutiv si në rastin me numër doculive (201000666). Mbajtja e një qëndrimi të tillë prej Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, bën të mundur shkeljen e afateve ligjore në kryerjen e procedurave për ekzekutim. Në asnjë akt ligjor apo nënligjor nuk i njihet e drejta Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor të kryej veprimin e tërheqjes së dosjes përmbarimore në çfardo faze ekzekutimi të ndodhet çështja për të cilën është krijuar ajo.

Për të gjithë rastet e prezantuara, në të cilat përcaktohet detyrimi i institucioneve apo organeve shtetërore të kryejnë një veprim të caktuar, duke përjashtuar detyrimin për pagimin e të hollave, është e pajustificueshme mbajtja e qëndrimi pengues prej tyre në përmbarimin e detyrimeve të vendosura, sikurse në rastet me nr.doculive 201001792, nr.201001466, nr. 201001028, nr. 201000736, nr. 201000274, nr. 200901831, nr. 201100655, nr. 201100563, nr. 201101364, nr. 201101884.

## **Konstatime**

Për vitin 2012, fluksi i depozitimit të ankesave, sipas të cilave shtetasit kanë kërkuar dhe kërkojnë rivënien në vend të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv, është në nivel të lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të

mëparshme. Për periudhën 1 Janar- 1Korrik 2012 janë depozituar 120 ankesa ku vendin kryesor e zënë ankesat ndaj institucioneve buxhetore për mospërmbushjen e detyrimit për pagimin e pages apo kryerjen e nje veprimi te caktuar.

Asnjë argument i përdorur nga administrata publike nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar ne rrugë gjyqesore. Kështu, në Vendimin e datës 18.11.2004 të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pas shqyrtimit të të parës çështje ankimore shqiptare, të ushtruar nga kreditori, firma e ndërtimit “Qufaj” sh.p.k, për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia Tirane, nënvizohet se : *“Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqesor”*<sup>4</sup>. Pra, me qëndrimin e mbajtur prej institucioneve buxhetore në mospërmbushjen e detyrimeve të vendosura, imazhi për seriozitetin e shtetit në mbrojtje të të drejtave të njeriut bie në një shkallë të papranueshme, në referim të sanksionimit të bërë në nenin 142/3 të Kushtetutës. Eshtë ky qëndrim i cili ka shtyrë subjekte të ndryshëm t’i drejtohen instancave të ndryshme, përfshirë dhe Institucionin e Avokatit të Popullit për të bërë të mundur gëzimin e së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore. Megjithëse Kushtetuta, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, sigurojnë pa asnjë dallim gëzimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sikurse kemi prezantuar në këtë Raport të Veçantë, kjo e drejtë vazhdon e shkelet prej organeve të Administratës Publike.

Shumat në të holla të vëna nga shteti në dispozicion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv, janë në nivele tepër të ulta, për rrjedhojë numri i çështjeve në ngarkim të institucioneve buxhetore debitore sa vjen e rritet, duke rritur në këtë mënyrë dhe faturën financiare që duhet paguar në favor të subjekteve gjyqfitues.

Kjo situatë bën të nevojshme, sikurse ka ndodhur me rastin e nxjerrjes së Urdhërit nr. 98, datë 14.07.2003, prej Kryeministrit, ringritjen e grupit të punës për evidentimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të paekzekutuara, me palë debitore institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe marrjen e masave për ekzekutimin sa më parë të këtyre vendimeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, që ne fillim te veprimtarise se tij, ka rekomanduar për shumë raste rivendosjen në vend të së drejtës për

---

<sup>4</sup> Nr.54268/00 "Qufaj&Co shpk k.Shqipërisë", date 30.03.2005

zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Ndëshkimet administrative apo procedimet për marrjen në përgjegjësi penale, të subjekteve të cilat me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë penguar ekzekutimin e titujve ekzekutiv, janë në raport të zhdrejta me problematiken e hasur në procesin e ekzekutimit të këtyre titujve. Edhe në ato raste të pakta, kur titullaret e institucioneve debitoare janë penalizuar nga zyrat e përmbarimit me gjoba, në bazë të nenit 606 të K.Pr.C. ato praktikisht nuk janë arritur të vilen, pasi gjykatat i kanë anuluar vendimet e përmbaruesve gjyqësorë. Në më të shumtën e rasteve konstatohet moskryerja e veprimeve prej përmbaruesve gjyqësor për dënimin me gjobë të debitorit si dhe çdo personi të tretë të cilët në procesin e ekzekutimit refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me ligj ose sipas urdhërit të ekzekutimit janë të detyruar.

Gjithashtu, rastet e kallzimit penal pranë organit të prokurorisë për kryejnë e veprës penale të pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, parashikuar i dënueshëm në nenin 320 të Kodit Penal, janë tepër të rralla. Referuar faktit se neni 531 i K.Pr.C. parashikon heqjen e së drejtës së disponimit nga ana e palës debitoare mbi kredinë e sekuestruar prej përmbaruesit gjyqësor, faktit se neni 581 K.Pr.C. parashikon detyrimin e palës së tretë të dorëzojë kredinë e sekuestruar, si dhe faktit të mosrespektimit të këtyre detyrimeve, rast pas rasti, prej palës debitoare si dhe personit të tretë, kuptohet se qëndrimi i përmbaruesit gjyqësor të çështjes, palës debitoare si dhe personit të tretë, përmbajnë elementet e kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë”, si dhe “Mosekzekutim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”, parashikuar të dënueshëm në nenin 248, 320 dhe 320/a të K.Penal.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, megjithëse ka marrë dijeni për qëndrimin e përmbaruesve gjyqësor, në rastet si sipërprezantuar, nuk ka ushtruar kompetencat e saj, bazuar në nenin 31 dhe 35/dh të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 : “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Gjyqësor” ose nuk rezultojnë të ketë kallzuar për ndjekje penale personin e ngarkuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile apo penale të formës së prerë.

Në ligjin nr.8510, datë 15.7.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore”, parashikohet përgjegjësia dhe detyrimi i organeve dhe i punonjesve të tyre, në rastet kur u shkaktojnë dëme pasuror dhe jopasuror personave fizike apo juridik private, vendas apo të huaj. Ky ligj bën pjesë në

ato ligje që nuk ka gjetur zbatim dhe nuk ka justifikuar qëllimin e ligjvënësit.

Megjithatë, duke parë numrin e dosjeve përbarimore që mbarten pa u ekzekutuar nga viti në vit dhe cilësinë e ekzekutimeve, bëhet imediate përmiresimi rrënjësor i organizimit të punës në zyrat e përbarimit në rrethe, duke punuar për forcimin e integritetit moral të përbaruesve, ngritjen në një nivel më të lartë të ndjenjës së përgjegjësisë dhe aftësisë profesionale në pajtim me frymën e normave proceduriale civile.

## **Konkluzione**

- Përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Përbarimit Gjyqësor Shtetëror për drejtimin dhe kontrollin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet të jenë më të mëdha dhe efikase.
- Rezulton ekzekutimi i diferencuar i titujve ekzekutivë. Ashtu sikunder prezantuar me sipër, nga njera ane KM, nxjerr akte për ekzekutimin e vendimeve të dhëna nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nga ana tjetër, duhet shprehur i njëjti vullnet në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga gjykatat shqiptare.
- Janë evidente mangësitë profesionale tek një pjesë e stafit përbarimor, zvarritje të pajustificuara gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, mungesa e transparencës dhe përkushtimi.
- Duhet rritur niveli i bashkëpunimit të përbaruesve gjyqësor .
- Ka mungesë bashkëpunimi midis përbaruesit gjyqësor me organe të tilla si Ministria e Financave, Policia e Shtetit, Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, organet e pushtetit vendor etj, mos-sqarim për të drejtat dhe detyrimet e paleve pjesëmarrëse në procesin e ekzekutimit dhe me vetë përbaruesin, fakt që reflekton në cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit.
- Duhet realizuar sa më shpejt unifikimi i praktikave përbarimore .
- Është i nevojshëm përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit Përbarimor Shtetëror.
- Mbetet domosdoshmëri një akt nënligjor për mënyrën dhe afatin maksimal të ekzekutimit të titujve ekzekutiv nga organet e shtetit

lidhur me detyrimet monetare apo kryerjen e nje veprimi te caktuar (neni 605 i KPrC).

- Krijimi i nje data base per pasqyrimin e te gjitha praktikave permbarimore ku debitore jane institucionet buxhetore.